

Prof. Dr. Iljaz REXHA, Prishtinë

SKËNDERBEU SIPAS KRONIKAVE OSMANE TË SHEKULLIT XV – XVI*

Duhet ta pranojmë faktin se për ngjarjet historike që kanë ndodhur në mesjetën e hershme dhe atë të vonë në tokat shqiptare, është shumë vështirë të shkruhet, sepse ato ngjarje, në mungesë të dokumenteve arkivore mbesin ngjarje të pandriçuara në mënyrë objektive dhe shkencore. Në mungesë të



dokumenteve arkivore dhe burimeve historike shërbejnë kronikat e proveniencave të ndryshme, e më së shumti kronikat osmane. Është e ditur në shkencë se, të gjitha kronikat e vjetra osmane, kanë zgjuar interes të madh për hulumtimin dhe studimin e Historisë së Perandorisë Osmane e njëkohësisht edhe për historinë e popujve të Ballkanit e veçanërisht për popullin shqiptar, i cili më së shumti qëndroi nën sundimin osman më se pesëqind vjeçar. Disa pjesë të vogla të këtyre kronikave janë përkthyer nga historiani i njohur, Selami Pulaha, mirëpo, në tërësi, ato kanë mbetur të pa hulumtuara dhe të pa përkthyer në mënyrë profesionale. Gjatë shfrytëzimit të këtyre kronikave duhet pasur qëndrim kritik ndaj të dhënave të tyre, dhe duhet krahasuar patjetër me burime të tjera të dorës së parë të po

* Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin Shkencor “Gjergj Kastrioti Skenderbeu dhe epoka e tij”, Prishtinë 21 nëntor 2005.

asaj periudhe që është themel për studimin e çfarëdo dokumenti apo burimi historik, për ta bërë restaurimin e ngjarjes burimore në mënyrë objektive.

Të dhënat nga kronikat osmane për tokat shqiptare, janë të rëndësishme, meqë i kanë shkruar disa kronistë që kanë marrë pjesë edhe në këto ngjarje ose për së afërmi i kanë vëzhguar, dhe nuk është rasti sikurse me kronikat osmane që bëjnë fjalë për Betejën e Kosovës të vitit 1389, ku nuk ka marrë pjesë asnjë kronist osman apo i huaj, por ato janë shkruar 50 ose 100 vjetë më vonë, në bazë të kujtesës të disa njerëzve që kanë dëgjuar se si është zhvilluar beteja e parë e Kosovës. Prandaj, kjo Betejë mbetet ende shumë e errët dhe hipotetike dhe nuk mund të argumentohet saktësisht se në çfarë kohe dhe hapësire është zhvilluar, meqë nuk ekziston asnjë dokument arkivor që do ta dokumentojë këtë ngjarje historike të hiperbolizuar dhe të mistifikuar nga ana e historiografisë serbe për ta bërë dallimin e hapësirës të Dardanisë, ndërsa historiografia turke nuk i jep rëndësi kësaj beteje, meqë sipas disa kronistëve osmanë, sulltan Muratin, babain dhe vëllain e tij Jakub Qelebinë, i vrau roja e Pajazitit, meqë, në fermanin e tij dërguar kadiut dhe guvernatorit Sylejman beut në Brusë, që ngjarjen për vdekjen e tyre ta mbajnë për një kohë në fshehtësi, duke i lajmëruar se është shpallur sulltan. Nga kjo del se ai nuk ka shpjeguar se si ishte vrasja e sulltani dhe të vërtetën mbi vrasjen e babait të tij e ka heshtur deri në varr.

Ndërsa, kronikat për marrëdhëniet shqiptaro – turke, na ofrojnë të dhëna për pozitën e shumë fisnikëve shqiptarë dhe principatave të tyre të asaj kohe, e sidomos për principatën e Gjon Kastriotit dhe të Skënderbeut gjatë viteve 20-30 të shek. XV. Po ashtu japin të dhëna sipas dëshmiave të kronistëve osmanë mbi ekspeditat ushtarake osmane dërguar kundër Gjon Kastriotit gjatë viteve 1423 –1437. Në vitet 1430-1431, forcat e osmanlinjve, nën komandën e Isa beut, të birit të Evronos beut, e thyen rezistencën e Gjon Kastriotit dhe i pushtuan tokat dhe kështjellat e tij. Gjatë këtyre viteve u regjistruan tokat e Gjonit dhe u inkuadruan nën sistemin feudal ushtarak të timarit osman. Këto burime tregojnë qartë se Gjon Kastrioti ka mundur të ruajë një pjesë të principatës së vet, duke u inkuadruar si fisnik i deriatëhershëm në shërbim të sulltanit dhe duke i mbajtur edhe pronat dhe tokat në krahinë e Mysjes nën qeverisjen e vet.

Këto kronika tregojnë se nuk është i rastit fakti se Gjon Kastrioti përmendet me emrin Hamza, si duket ka qenë i detyruar ta pranonte fenë islame formalisht, duke treguar diplomaci të mençur,

me qëllim për t'i ruajtur dhe qeverisur edhe më tej pronat e tij në Shqipërinë Qendrore.

Pushtimi nga ana e osmanlinjve si edhe përpjekjet për ta konsoliduar pushtetin e tyre në tokat shqiptare, hasën në një qëndresë të fortë, jo vetëm nga fisnikët, por edhe nga popullsia shqiptare.

Konflikti i armatosur midis osmanëve dhe Gjon Kastriotit, solli deri te një sulm kundër Krujës, i cili ndodhi rreth vitit 1436. Ky konflikt, ka qenë shkas që, e shtyri Gjon Kastriotin në vitin 1437 të kërkonte mbrojtje dhe përkrahje nga Venediku, jo vetëm për veten e tij, por edhe për të birin, Gjergjin. Si pasojë e masave që i mori Porta e Lartë, të shkaktuara nga dyshimi që zgjoi qëndrimi i Skënderbeut, i cili, përveç lidhjeve që i mbante me babain, duhet të kishte dijeni edhe për lëvizjet tjera të rezistencës që zhvilloheshin në këtë kohë në Shqipërinë Qendrore. Në bazë të një dokumenti osman, hartuar nga një funksionar i lartë, Mustafa beu, rreth vitit 1430, në të cilin Skënderbeu del në pozitën e një timarniku. Në të njëjtin dokument thuhet se Skënderbeu, e kërkon ziametin e krahinës së Mysjes, që ishte pronë e babait të tij – Gjonit.

Në vazhdim, në dokument thuhet se, meqë babai i tij Gjoni, si sundimtar i Shqipërisë Qendrore dhe Mysjes, kishte zhvilluar shumë luftëra kundër osmanëve, tash biri i tij, Skënderbeu, kërkon të sundojë në këtë krahinë, e ky është i biri i atij sundimtarit të vjetër të këtij vendi, andaj, kjo kërkesë e tij nuk mund të merret parasysh për t'ia dhënë atij ziametin e lartpërmendur. Kronikat osmane ofrojnë të dhëna për shumë beteja dhe luftëra që janë zhvilluar midis forcave shqiptare të udhëhequra nga Skënderbeu dhe ushtrisë osmane. Njëra ndër luftërat më të ashpra, që u zhvillua në mes forcave të Skënderbeut dhe forcave osmane, të udhëhequra nga Isa Beg Evrenozi, ishte aq e ashpër sa që as njëra palë nuk arriti fitoren përfundimtare.

Kronistët osmanë na sjellin gjithashtu edhe disa të dhëna të reja për zhvillimin e luftërave gjatë periudhës së sulltan Muratit II, si edhe gjatë fushatave të sulltan Mehmetit II, në vitet 1466-1467. Sipas këtyre kronistëve, dhe burimeve tjera osmane dhe perëndimore, sulltan Mehmeti II, bashkë me të gjitha forcat ushtarake të Perandorisë osmane, depërtoi në brendi të Shqipërisë në muajin maj 1466 dhe, me këtë rast i theu forcat e Skënderbeut dhe i mori të gjitha territoret që përfshinte shteti i tij, me përjashtim të qytetit të Krujës me rrethinë, të cilat u bënë ballë sulmeve të pandërprera të armatës osmane. Skënderbeu, nga ana e sulltan Muratit II (i cili u edukua së bashku me të birin e tij sulltan Mehmetin e II), u pagëzua me epitetin Leka i

Madh, meqë, në shumë luftëra që ai i zhvilloi, në kuadër të ushtrisë osmane, tregoi një heroizëm dhe trimëri të pashembullt dhe gjatë betejave, kur dilte në dyluftim kundër shumë pehlivanëve të ndryshëm, në praninë e sulltanit, ai gjithnjë fitonte. Pastaj, disa kronistë e krahasonin në mënyrë figurative me Xhin Gin Skanin dhe Timurlenkun për shkathtësitë dhe aftësitë e tij luftarake që tregoi gjatë fushatave ushtarake, kurse kur u ngrit kundër sulltanëve, e paraqitën me epitete të ulëta përbuzëse.

Skënderbeu, qysh nga koha kur ishte në oborin e sulltanit, në radhët e ushtrisë osmane, parashikonte që pas vdekjes së babait të tij, njëri nga vëllezërit e tij, ose ai vet, të bëhej princ i principatës së Kastriotëve të trashëguar nga babai i tij – Gjoni, prandaj, kërkonte rastin e volitshëm për ta lëshuar ushtrinë osmane dhe kështu ndodhi kur, në vitin 1443, ishte dërguar ushtria osmane në Luftën e Moravës. Ky me një numër të vogël shqiptarësh, iku nga ushtria osmane dhe arriti në Krujë, duke i rikthyer tokat dhe pronat e babait të vet. Ai menjëherë filloi të organizonte rezistencën gjithë popullore kundër pushtetit osman, duke i thirrur princat dhe krerët e tjerë të Shqipërisë për një Besëlidhje dhe bashkim të vërtet, nga të cilët u zgjodh dhe u njoh për kryekomandant të forcave shqiptare në mbarë Shqipërinë. Kronistët osmanë, rezistencën 25 vjeçare të Skënderbeut kundër ushtrisë osmane, e përshkruajnë se ai është përkrahur nga mbretërit e krishterë të Evropës, e sidomos nga papa dhe mbreti i Hungarisë, duke e konsideruar se ai do të jetë një mburojë hekuri kundër depërtimit të mëtejshëm të Perandorisë Osmane në këto vende, të cilët e nxitnin vazhdimisht të luftojë kundër ushtrisë osmane, kurse kryengritjen dhe rezistencën gjithë popullore të shqiptarëve, të udhëhequr nga Skënderbeu, janë munduar ta mohojnë, ndërsa Skënderbeun dhe ushtarët e tij i quanin rebelë, komfortë, tradhtarë dhe kundërshtarë të Perandorisë Osmane. Disa prej këtyre shteteve kishin bërë marrëveshje me Perandorinë Osmane për mos sulmim, ndërsa nga ana tjetër, Skënderbeun e kishin zhytur në luftëra kundër ushtrisë osmane, dhe të njëjtat vetëm i shikonin nga larg. Sipas tyre, Skënderbeu, bëri rezistencë të madhe gjysmë shekullore edhe në saje të konfiguracionit të pozitës gjeografike të Krujës me rrethinë si edhe përgatitjeve të tij të veçanta luftarake dhe strategjike, duke iu larguar luftës frontale, ka mundur t'i përballojë sulmit të ushtrisë së madhe osmane të udhëhequra nga sulltan Murati II dhe sulltan Fatihu me komandantët ushtarake të tyre.

Administrata osmane bëri përpjekje të vendos përfundimisht pushtetin e saj në këto zona, duke bërë regjistrimin e tokave, të cilat administrativisht iu bashkëngjitën Sanxhakut të Ohrit. Të dhënat tjera të burimeve narrative osmane, vënë në dukje se pushteti osman në këto zona ishte i pa konsoliduar, prandaj, sulltani, duke pasur frikë nga një sulm i ri i Skënderbeut, e kaloi dimrin në Filibe të Bullgarisë. Kronikat osmane vërtetojnë se sulltan Murati II, gjatë viteve 1448 dhe 1450, si edhe sulltan Mehmeti II në vitet 1466-1467 dhe në vitin 1478, me ushtritë e tyre të mëdha të Perandorisë Osmane, ndërmorën fushata luftarake të rëndësishme me qëllim që të thyenin qëndresën dhe rezistencën e popullit shqiptar të udhëhequr nga Skënderbeu. Këto burime pohojnë faktin se të dy këta sulltanë të fuqishëm me komandantët e tyre të njohur pësuan disfata përpara fortesave të Krujës dhe të Shkodrës. Në këto kronika, gjejmë të dhëna edhe mbi tradhtinë e Hamza Kastriotit e të Mojsi Golemit, të cilët kishin kaluar në anën e sulltanëve dhe e kishin tradhtuar Skënderbeun, por më vonë Skënderbeu që të dy i zuri. Gjithashtu, këto kronika na njoftojnë se gjatë fushatave ushtarake shumë fisnikë shqiptarë shkëputeshin nga Skënderbeu dhe kalonin në anën e osmanlinjve, gjë që i dobësonin forcat luftarake të Skënderbeut. Kjo shkëputje dhe tradhti këtyre fisnikëve shqiptarë, bëhej për shkak se ata donin ta ruanin pavarësinë e pronave dhe territoreve të tyre dhe për këtë arsye ishin kundër pushtetit centralist që mendohej ta organizonte dhe ta zbatonte Skënderbeu. Kronistët osmanë luftën e popullit shqiptarë e paraqitën të mbështetur nga pozitat e pushtuesit dhe forcës së tyre nga interesat e klasës feudale osmane. Ata u munduan nga njëra anë që të zvogëlojnë ose të paraqesin në formë tepër të butë ose t'i mohojnë humbjet që në shumicën e rasteve kishte pësuar ushtria osmane gjatë luftërave që u zhvilluan për nënshtrimin e popullit shqiptar, ndërsa nga ana tjetër t'i smadhonjë fitoret e tyre, bile edhe në shumë raste humbjet e tyre t'i paraqesin si fitore.

